

---

**NEKROLOGJI**

---

**ALI DHRIMO**

(29.03.1939–16.11.2011)

Këtë vit gjuhësia shqiptare humbi një nga zërat e saj më të njohur, prof. dr. Ali Dhrimon, i cili ndërroi jetë më 16 nëntor 2011, në moshën 72-vjeçare, pas një sëmundjeje të rëndë dhe sflitëse. Lindur në fshatin Çorraj të rrethit të Sarandës, shkollën e mesme e kreu në Tiranë, kurse studimet universitare, që i filloi në Lajpcig dhe i vijoi në Frajberg të Gjermanisë për inxhinieri, i përfundoi më 1963 në Universitetin e Tiranës për gjuhë shqipe dhe letërsi.

Karriera shkencore dhe profesionale e prof. dr. Ali Dhrimos është shumë e pasur. Pas diplomimit, ai u emërua në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, në sektorin e gramatikës, ku punoi deri më 1975, për të kaluar me qarkullim në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”. Në vitin 1980 emërohet kryeredaktor i revistës “Gjuha jonë”, të cilën, falë talentit të tij organizues dhe tërheqjes së një numri të madh bashkëpunëtorësh, e ktheu në një organ shkencor të dashur për gjuhëtarët, për studentët dhe mësuesit e gjuhës shqipe.

Veç punës si studiues në fushën e gramatikës dhe si redaktor, ndihmesat e tij janë të mëdha edhe në fushën e mësimdhënies. Gjatë periudhës 1992–1997 kreu detyrën e dekanit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, ku themeloi departamentin e gjuhës gjermane, të cilin e drejtoi derisa u pensionua më 2003. Në këtë Fakultet, në fillim si pedagog i jashtëm, ka dhënë gjuhën gjermane, gramatikë të sotme dhe gramatikë historike të gjuhës gjermane, leksikologji gjermane, teori përkthimi etj. Si pedagog i jashtëm ka dhënë mësim edhe në degën e gjuhës shqipe të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë. Pas pensionimit, ai e vijoi punën në arsimin privat, si dekan i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në universitetin “Marin Barleti” deri në vitin 2004.

Prof. Dhrimoja ka qenë mjaft aktiv në veprimtaritë shkencore brenda e jashtë vendit. Ai ka përfaqësuar gjuhësinë shqiptare në shumë tubime shkencore ndërkombëtare, me kumtesa apo ligjërata në kongrese, konferenca gjuhësore të ndryshme, si në Gjermani, Austri, Angli, Zvicër, Poloni, Greqi, Kosovë e Maqedoni. Në vitin 1974 kreu kërkime arkivore e bibliografike në Bibliotekën e Universitare dhe në Bibliotekën Mbretërore në Kopenhagë, ku zbuloi një thesar të vërtetë për gjuhën shqipe, dorëshkrimet e të gjithë figurave të shquara arbëreshe dhe të albanologut të madh danez Holger Pedersen.

Ai ka qenë edhe një veprimtar shoqëror i palodhur. Ishte anëtar i “Shoqatës së Gjermanistëve të Austrisë” (Vjenë), i “Shoqatës Shiler” Marbah (Gjermani), i “Shoqatës së Miqve të Institutit për Gjuhë Gjermane” (Manhajm, Gjermani) dhe anëtar nderi i shoqatës shqiptaro-gjermane “Robert Schwartz” (Tiranë). Gjatë periudhës 1999-2003 ka qenë anëtar i këshillit drejtues të Fondacionit për Kulturë dhe Art “Fan S. Noli” dhe nga 2003 deri në nëntor 2005 kryetar i këtij Fondacioni.

Veçanërisht të mëdha janë ndihmesat e prof. dr. Dhrimos në fushën e kërkimeve për gjuhën shqipe. Këto arritje e kanë burimin në punën e tij të palodhur për formimin shkencor nëpërmjet studimit të ngulët dhe ndjekjes së literaturës gjuhësore bashkëkohore. Formimin e tij shkencor ai e konsolidoi edhe nëpërmjet qëndrimeve të herëpashershme në Gjermani, me bursën e fondacionit gjerman “Aleksandër fon Humboldt”, të cilën e pati fituar katër herë. Më 1982 merr gradën “Kandidat i Shkencave”, më 1986 titullin “Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor” dhe më 1994 titullin “Profesor Doktor”. Zotëronte gjuhën gjermane, ruse dhe angleze. Ai ishte një nga gjermanistët më të mirë të vendit dhe një njohës virtuoz i gjuhës gjermane.

Falë këtij formimi, ai la pas një trashëgimi shumë të pasur shkencore, që përfshin monografi, fjalorë të shqipes dhe fjalorë dygjuhësh, si dhe studime, artikuj e kumtesa të shumta. Fushat e gramatikës më të lëvruara prej tij janë mbiemri, emri dhe folja, të cilave u ka kushtuar një numër të madh studimesh të botuara në revistat shkencore “Studime filologjike”, “Gjuha jonë”, në përmbledhje gjuhësore, po edhe në revista shkencore gjermane. Studimet e tij për gramatikën e gjuhës shqipe dallohen jo vetëm për larminë e temave, por edhe për trajtimin e tyre me kompetencë shkencore. Ndër ndihmesat e tij më me vlerë janë monografitë “Mbiemrat në shqipen e sotme letrare” (1982) dhe “Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe” (1986), dy tema sa të rëndësishme, aq edhe të vështira, të cilat ai ka ditur t’i trajtojë me mprehtësi, duke sjellë vështrime të reja dhe mendime tepër origjinale për një varg çështjesh. Ai është bashkautor i tekstit akademik “Fonetika dhe gramatika e gjuhës letrare shqipe”, II, Morfologjia (1976), me kërret e mbiemrit, të numërorit dhe të përemrit pronor.

Të shumtë janë artikujt e botuar prej tij në shtypin shkencor, ndër të cilat vlen të përmenden shkrimet “Një vështrim mbi foljet me më se një reksion në shqipen e sotme letrare” (1965), “Vëzhgime rreth ngulitjes së normës gjuhësore në publicistikën e pasçlirimit” (1969), “Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe” (1972), “Probleme të normës te shumësi i disa emrave” (1980), “Probleme të normës në sistemin foljor të gjuhës shqipe” (1983), “Paralelizma kuptimorë ndërmjet trajtave foljore me *po* (po punoj) dhe *jam* + përcjellore (jam duke punuar)” (1986), Mënyra intensive e veprimit foljor dhe përdorimi i saj në gjuhën shqipe” (1990), “Lidhje fonetiko-

morfolojike në drejtshkrimin e gjuhës shqipe” (1994), “Edhe një herë rreth ngulitjes së normës letrare në publicistikën tonë” (2001) etj.

Ajo që i dallon studimet e tij në fushë të gramatikës së shqipes është thellësia e mendimit dhe forca e argumentit, të cilat i kishin rrënjët edhe në formimin e tij bazë në shkencat e sakta. Shumë nga propozimet e tij janë pasqyruar në gramatikën akademike të shqipes, kurse një pjesë tjetër e tyre që nuk qenë pranuar, janë jetësuar në veprën postume “Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe” (2011).

Një fushë tjetër studimi, së cilës iu kushtua me tepër pasion, qe onomastika. Në këtë fushë ai botoi një monografi model për toponiminë e Kurveleshit, që është me shumë interes për historinë e gjuhës shqipes. Në këtë monografi, përveç analizës së strukturës morfolojike të toponimeve dhe veçorive gjuhësore të së folmes së kësaj treve që zbulohen nga onomastika e saj, jepen edhe shpjegime etimologjike për disa emra vendesh, që në një vështrim të parë duken si të pashpjegueshëm.

Shumë të mëdha janë ndihmesat e prof. Dhrimos në fushën e fjalorëve, të cilëve u kushtoi 15 vjetët e fundit të jetës së vet. E nisi me “Deutsch-Albanisches Wörterbuch” (me bashkautorësi, në dy vëllime dhe me 82 mijë fjalë (Wiesbaden, 1996); “Fjalor gjermanisht-shqip” me 45 mijë fjalë (1998); Fjalor gjermanisht-shqip me 30 mijë fjalë (1999), “Fjalor shqip-gjermanisht” me rreth 50 000 fjalë (2005) dhe “Fjalor gjermanisht-shqip” me 61 mijë fjalë (2007). Këta fjalorë, që janë ndër më të mirët fjalorë dygjuhësh tek ne, dëshmojnë për një njohje të thellë të leksikut të shqipes dhe të gjermanishtes si dhe të parimeve të shkencës së leksikografisë.

Lënda e mbledhur për fjalorët gjermanisht-shqip e shqip-gjermanisht i shërbeu prof. Dhrimos si bazë për t’u marrë edhe me hartimin e fjalorëve të gjuhës shqipe. Kështu, në bashkëpunim me gjuhëtarët E. Tupe e E. Ymeri, më 2002 botoi “Fjalorin sinonimik të gjuhës shqipe”, me 30 mijë zëra, i cili, i ripunuar dhe i zgjeruar me 5 mijë zëra të tjerë, u ribotua më 2005. Vepra e fundit e tij, e hartuar në bashkëpunim me gjuhëtarin R. Memushaj, është “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe”, që u botua në prill të vitit 2011. Kësaj vepre madhore për normën drejtshkrimore e morfolojike të shqipes standarde, në të cilën leksiku i gjuhës sonë paraqitet për herë të parë me mbi 70 mijë njësi leksikore, ai i kushtoi tre vjetët e fundit të jetës, duke punuar me ngulm deri në përfundim të saj, në luftë me sëmundjen e rëndë që e rrëgjoi dalëngadalë derisa e ndau nga jeta.

Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe ndihmesat e prof. dr. Dhrimos në fushat e përkthimit, të redaktimit dhe të publicistikës. Penës së tij i përkasin shumë artikuj gjuhësorë të Pedersenit, Joklit, Majerit etj. të përkthyer shqip, si dhe vepra të plota të kthyera nga shqipja në gjermanisht e anasjelltas. Gjatë kohës që punoi në Shtëpinë botuese “8 Nëntori”, në redaksinë e botimit të

veprave në seri të shkrimtarëve tanë, ai redaktoi dhe përgatiti për botim veprën e plotë të Sterjo Spasses dhe të Fatmir Gjatës, si edhe shumë përkthime veprash autorësh gjermanë.

Nga fusha e publicistikës, vlejné të përmenden artikujt e shumtë të tij për albanologë të huaj dhe shqiptarë, për vepra shkencore, për probleme të mësimit të gjuhës së huaj, si dhe për probleme të zhvillimeve demokratike e të mbrojtjes së interesave tona kombëtare, duke spikatur si një intelektual që nuk u mbyll në kullën e fildishtë, por u shqetësua për fatet e atdheut dhe të shoqërisë shqiptare.

Me ndarjen e prof. Ali Dhrimos nga jeta, familja dhe miqtë humbën njeriun e dashur, ndërsa gjuhësia shqiptare një gjuhëtar të shquar, që la pas një prodhimtari të pasur shkencore. Studimet e tij do të shërbejnë si pikë referimi për kërkime të reja gjuhësore; fjalorët e tij dygjuhësh do të jenë gjithmonë mbi tryezën e punës të atyre që mësojnë gjermanisht; kurse fjalori sinonimik dhe fjalori drejtshkrimor në dorë të krijuesve, redaktorëve, gjuhëtarëve, studentëve e nxënësve. Jo vetëm vepra, por edhe kuraja e tij e jashtëzakonshme për të mposhtur sëmundjen dhe për të mos e lëshuar penën nga dora edhe në çastet e fundit përbëjnë një shembull për të mos u dorëzuar para fatkeqësive të jetës dhe vuajtjeve të sëmundjes.

**Rami Memushaj**

## TABLE OF CONTENTS

|   |   |     |
|---|---|-----|
| KOLEC TOPALLI                                     | From “Etymological dictionary of Albanian” II.....  | 5   |
| INA ARAPI   | On the overlapping grammatical and lexicographical elements of Aromanian, Romanian and Albanian language according to a modern grammar.....   | 35  |
| VALTER MEMISHA                                    | On the flexibility of the lexical and semantic norm of standard Albanian language.....  | 53  |
| ENKELEIDA KAPIA,<br>ANILA KANANAJ<br>FLORA KOLECI | Ordering of postnominal phrases in modern Albanian.....   | 67  |
|   | Analysis of restrictive relative phrases in Albanian.....   | 81  |
| HAJRI SHEHU                                       | Issues of spoken language in mass media channels.....   | 93  |
| ARTUR LAMAJ                                       | Lexical variations in the Atlas of Albanian language dialects.....  | 99  |
| LEDI IKONOMI                                      | Evoking tradition through intersexuality in Camaj’s poetry.....   | 109 |
| AGRON GJEKMARKAJ                                  | The genre of recollections, epistles and biography in Albanian literature.....  | 127 |
| ERIONA TARTARI                                    | “Krushqit janë të ngrirë”, a political engagement of Kadare.....  | 139 |
| BRIKENA SMAJLI                                    | A look of Martin Camaj’s poetry through T. S. Eliot.....  | 149 |
| <br>CRITIQUES AND REVIEW                          |   |     |
| KOLEC TOPALLI                                     | On the origin of infinitive in Albanian language (related to the discussion of Prof. Marco Gabinski).....   | 159 |
| EVALDA PACI                                       | “Recherches sur les anciens textes albanais” on the 80 <sup>th</sup> anniversary of its first edition   | 163 |
| KLARA KODRA                                       | “Camaj i paskajuar” by Shaban Sinani.....   | 173 |
| HAJRI SHEHU                                       | “Termi dhe fjala në gjuhën shqipe” by Agron Duro.....   | 177 |
| TOMOR OSMANI                                      | “Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes” by Mimoza Priku.....  | 183 |
| INA ARAPI   | “Lexikon der Sprachwissenschaft” ( <i>Dictionary of linguistics</i> ) by Hadumod Bußmann (editor). Forth controlled and completed edition with bibliographic data. In cooperation with Hartmut Lauffer..... | 187 |

## SCIENTIFIC LIFE

|  |     |
|--|-----|
| Doctoral dissertation and Master's theses defenses (L. Smaqi, R. Vata).....  | 191 |
| Scientific Conference "100 years with Migjeni", on the occasion of 100 <sup>th</sup> anniversary of his birth (L. Smaqi).....    | 193 |
| International Scientific Symposium "Oral literature and Albanian national identity" (K. Topalli).....                            | 194 |
| Scientific Conference "Fishta in today's literary research" (on 140 <sup>th</sup> anniversary of Fishta's birth) (L. Smaqi)..... | 195 |
| The Conference "Albanian language and languages of the Balkan", - held in Prishtina, 10-11 November 2011 (K. Topalli).....       | 196 |
| Plenary session "The protection of Albanian cultural heritage in Macedonia", 21 November 2011 (K. Topalli).....                  | 201 |
| Scientific meeting about "Modern developments in linguistics and studies on Albanian", Tirana, December, 2011 (A. Kananaj).....  | 202 |
| <br>   |     |
| NECROLOGY  |     |
| Ali Dhrimo (29.03.1939 – 16.11.2011).....  | 203 |